



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 9/5 Prot.

Tiranë, më 26 . 07 . 2023

V E N D I M

Nr. 143, Datë 26 . 07 . 2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 2 Regj., datë 04.01.2023¹, e subjektit ankues E. T, kundër Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër², me pretendimin e diskriminimit për “*çdo shkak tjetër*”³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, me detyrë “Mjek familje” në Qendrën Shëndetësore Rrethina, me shkresën me nr. 729/4, datë 27.08.2021 të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, Shkodër, është emëruar⁴ në pozicionin “Drejtor/Mjek” pranë Qendrës Shëndetësore Rrethina, Shkodër, deri në kryerjen e procedurave standarde.

Znj. T gjatë parashtrimeve është shprehur se, që nga marrja e detyrës, përveç detyrave të natyrës administrative ka mbuluar me shërbim mjekësor dy ambulanca “Shtoj i Ri”, e cila përfshin edhe ambulancën “Dobraç i Ri”, pasi nuk ka në strukturë vend vakant për mjek, dhe ambulancën “Hot i

¹ Plotësuar nga subjekti ankues me e-mailin e datës 16.01.2023.

² Në vijim referuar edhe si DRFSDKSH Shkodër.

³ Subjekti ankues ka shpjeguar se në këtë shkak ka klasifikuar konfliktin e krijuar mes saj dhe titullarit të DRFSDKSH Shkodër.

⁴ Emërim i përkohshëm.

Ri”. Shërbimi mjekësor për banorët e këtyre zonave është mbuluar nga ana e ankueses, për të cilin ajo shprehet se:

“...duke u bazuar në kontratën time të punës, por edhe në praktikën e drejtuesve të mëparshëm, kam dërguar kërkesën për miratim mbingarkesë pune, pranë DRFSDKSH Shkodër, kërkesë e cila me është miratuar me shkresën me nr. 11142/1 prot., datë 26.10.2021.

Me shkresën me nr. 15 prot., datë 10.01.2022 kam dërguar kërkesën me të njëjtin objekt për rimiratim të mbingarkesës së ambulancës Hot i Ri prej 2500 banorësh. Me shkresën me nr. 53/1 prot., datë 13.01.2022 DRFSDKSH Shkodër më ka kthyer përgjigje se ngarkesa e mësipërme nuk miratohet. Nga ana e Drejtorit brenda 3 muajve është mbajtur qëndrim i ndryshëm për kërkesa me objekt të njëjtë.

Në shkresën e mësipërme citohet se: “Drejtorja Edona Tafa mbulon ambulancat Shtoj i Ri dhe Dobraç me 7361 banorë, numër shumë i lartë ky për një drejtor i QSH-së dhe drejtori mbulon numër më të madh se norma e caktuar, vetëm atëherë kur nuk ka alternativë tjetër.

Së pari, në kontratën DRFSDKSH-QSH, në asnjë nga nenet e pikat e kësaj kontrate nuk cilësohet numri maksimal i banorëve që duhet të mbulojë një drejtor i një QSH-je.

Së dyti, përse një numër banorësh konsiderohet i lartë për mua ndërkohë që po të njëjtën mbingarkesë apo dhe më shumë e ka mbajtur drejtuesi paraardhës, i cili sot drejton DRFSDKSH Shkodër? Cili është kriteri matës?”.

Ankuesja është shprehur se në shkresën sipërcituar, Drejtori i DRFSDKSH Shkodër ka shpjeguar se, DRFSDKSH Shkodër pasi ka monitoruar mbulimin shëndetësor të QSH Rrethina, ai ka rezultuar jokorrekt, por pa argumentuar si ka arritur në këtë konkluzion dhe pa bërë asnjë vlerësim të performancës të saj si mjeke apo si drejtuese e QSH Rrethina.

Ankuesja shprehet se motivacioni mbi të cilin është bazuar mosmiratimi i mbingarkesës së punës nga ana e DRFSDKSH Shkodër, ka ardhur si hakmarrje e Drejtorit të këtij Institucioni, për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe tij (ish-Drejtor i QSH Rrethina, aktualisht Drejtor i DRFSDKSH Shkodër), konflikt, të cilin e ka shpjeguar si më poshtë vijon⁵:

“1. Në përfundim të vitit, si përmbyllje e aktivitetit të Qendrës Shëndetësore, është inventarizimi i pajisjeve që ndodhen, i cili pasi përmbillet i bashkëngjitet bilancit vjetor që paraqitet në Drejtorinë Rajonale të Fondit⁶, në fillim të vitit pasardhës. I njëjti proces pune është ndjekur dhe nga ana ime në përfundim të vitit 2021, së bashku me ekonomisten. Kjo e fundit, që ditët e para të Janarit 2022 më ka referuar që gjatë procesit të inventarizimit janë evidentuar mungesa të pajisjeve. Gjithashtu, asnjë nga personat përgjegjës nuk kishin firmosur për pajisjet që kishin nën ngarkim. Në kushte të tilla, nga ana ime është refuzuar që të firmoset pasqyra përmbledhëse e inventarit për vitin 2021 dhe Bilanci. Këtë problematikë, e kam referuar pranë Drejtorit Rajonal, Zyrës së Financës së Drejtorisë Rajonale të Fondit dhe është lehtësisht e verifikueshme që deri në muajin Prill 2022, për shkak të mungesave në pajisje as personeli përgjegjës nuk ka firmosur për pajisjet (disponoj fotot e dokumentave të pafirmosura, por kjo mund të konfirmohet edhe nga ekonomistja e Qendrës Shëndetësore Rrethina). Pavarësisht kërkesës së DRF, kam

⁵ Referuar e-mailit të datës 16.01.2023

⁶ Referuar me akronimin DRF, nga ana e vetë Institucionit.

pranuar të firmos inventarin e vitit 2021, vetëm pasi është plotësuar me pajisjet fizike të pranishme në fund të muajit Prill 2022.

Kjo situatë ka nisur që javën e parë të Janarit 2022, pra rreth dy javë përpara ardhjes së shkresës së DRF, ku nuk miratohej sërish mbingarkesa ime.

2. Lidhur me krahasimin me persona të tjerë që ndodhen në të njëjten situatë, krahasimi i vetëm që unë mund të bëj është vetëm me paraardhësin tim në atë detyrë z.Gjoka. Kjo pasi, Qendrat Shëndetësore mbulojnë banorët e një njësie administrative. Si rrjedhojë, duke qenë se Njësia Administrative Rrethina është më e madhja në Qark, e kam të pamundur të krahasohem me Drejtuesit e Qendrave të tjera Shëndetësore, të cilët mbulojnë njësi më të vogla administrative.

3. Ndaj Drejtorisë Rajonale të Fondit, që nga marrja e shkresës së parë, kam tentuar të kryej ankimin në raport me vendimin e tyre, ose më saktë të sqaroj situatën, duke kërkuar së pari arsyen e ndryshimit të qëndrimit të tyre bazuar në një raport kontrolli mbi punën time siç parashikon kontrata, por edhe duke i sqaruar lidhur me mbulimin shëndetësor që është vendosur ashtu, bazuar në komunikimin me mjekët e QSH. Në asnjë nga shkresat, nuk kam patur argument lidhur me vendimin”.

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj të konstatojë diskriminimin nga ana e DRFSDKSH, Shkodër, dhe të marrë masa për rivendosjen në vend të së drejtës të cenuar nga punëdhënësi kundrejt saj, në marrëdhënien e punësimit.

- Në kuadër të parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar në vijimësi pranë KMD-së, nga subjekti ankues, si në rrugë postare, ashtu dhe në rrugë elektronike (me email), Komisioneri evidenton faktin se ato janë depozituar në dosjen e ankueses dhe janë vlerësuar gjatë vendimmarrjes së KMD-së, bashkërisht dhe në harmoni me pretendimet dhe faktet e provat e tjera.

Lidhur me kërkesën e Komisionerit për shpjegimin e dokumentimin e shkakut të pretenduar nga ankuesja “për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe Drejtorit të DRFSDKSH Shkodër⁷”, ajo ka parashtruar si më poshtë vijon:

“Në përfundim të vitit, si përmbyllje e aktivitetit të Qendrës Shëndetësore, është inventarizimi i pajisjeve që ndodhen, i cili, pasi përmbillet, i bashkëngjitet bilancit vjetor që paraqitet në Drejtorinë Rajonale të Fondit, në fillim të vitit pasardhës. I njëjti proces pune është ndjekur dhe nga ana ime në përfundim të vitit 2021, së bashku me ekonomisten. Kjo e fundit, që në ditet e para të muajit Janar 2022, më ka referuar që gjatë procesit të inventarizimit janë evidentuar mungesa të pajisjeve. Gjithashtu, asnjë nga personat përgjegjës nuk kishin firmosur për pajisjet që kishin në ngarkim. Në kushte të tilla, nga ana ime është refuzuar të firmoset pasqyra përmbledhëse e inventarit për vitin 2021 dhe Bilanci. Këtë problematikë, e kam referuar pranë Drejtorit Rajonal, Zyrës së Financës së Drejtorisë Rajonale të Fondit dhe është lehtësisht e verifikueshme që deri në muajin Prill 2022, për shkak të mungesave në pajisje, as personeli përgjegjës nuk ka

⁷ Klasifikuar si “çdo shkak tjetër”

firmosur për pajisjet. Pavarësisht kërkesës së DRF, kam pranuar të firmos inventarin e vitit 2021, vetëm pasi është plotësuar me pajisjet fizike të pranishme, në fund të muajit Prill 2022.

Lidhur me inventarin e QSH “Rrethina”, po sqaroj dy gjëra lidhur me të cilat jam informuar nga ekonomistja në fillim të muajit Janar 2022:

- Në njërën nga ambulancat e QSH-së, konkretisht ajo “Bleran”, është evidentuar mungesa e një pajisjeje oksigjeni, lidhur me të cilën infermierët referojnë që nuk ndodhej aty pasi ishte marrë nga ish-drejtuasi A. Gj, gjatë periudhës së COVID-19, por nuk ishte kthyer më.
- Një pajisje e cila, ishte blerë në periudhën kur A. Gj mbante detyrën e Drejtorit të QSH “Rrethina” u referua nga infermierët e ambulancës “Hot i Ri”, që mungonte.

Këtë problematikë e kam referuar disa herë si pranë Zyrës së Financës së Drejtorisë Rajonale Shkodër, por edhe pranë z. A.Gj, me qëllim zgjidhjen e problematikës pasi ishte e pamundur për mua të firmosja përmbledhësen e një inventari ku mungonin pajisje fizikisht (dhe ku infermieret nuk mbanin përgjegjësi për mungesën e tyre). Nuk kam marrë përgjigje dhe nuk ka patur asnjë zgjidhje të problemit. Në muajin Prill 2022, jam detyruar të kryej inventarizimin e pajisjeve së bashku me ekonomin, ku u evidentuan mungesat në pajisje dhe vetëm pas insistimit për gjetjen e pajisjeve, kam firmosur Bilancin e vitit 2021, që në përbërje kishte dhe Inventarin e vitit 2021. Si rrjedhojë, është dorëzuar pranë Zyrës së Financës së Drejtorisë Rajonale Shkodër”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁸, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar”, duke përcaktuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht:

⁸ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun II, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, të tij parashikon se:

“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.....”

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 9/1 prot., datë 19.01.2023, Komisioneri i është drejtuar DRFSDKSH Shkodër, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion provues, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, DRFSDKSH Shkodër, me shkresën nr. 89/1 prot., datë 24.01.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera, si vijon:

“Qendra Shëndetësore, është institucion shëndetësor në varësi të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vijim Operatori) që jep shërbim shëndetësor në kujdesin parësor. Sa më sipër, sqarojmë se, Drejtoritë Rajonale të FSDKSH-së, nuk lidhin kontratë pune individuale me personelin e QSH, por lidhin kontrata dypalëshe financimi, në të cilën janë përcaktuar qartë të drejtat e detyrimit e secilës palë, duke rregulluar në këtë mënyrë marrëdhënien ndërinstitucionale.

QSH është e detyruar t'i drejtohet DRF për miratimin e ngarkesës mbi normën e standardeve të miratuara dhe jo siç pretendohet nga ana e znj. E. T (duke u bazuar në kontratën time të punës apo edhe në praktikën e drejtuesve të mëparshëm).

Sa i takon pretendimet të znj. T për përcaktimin e numrit maksimal të banorëve që duhet të mbulojë një Drejtor i QSH-së, në kontratën dypalëshe, sqarojmë se ky numër është i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, numër i konfirmuar edhe në Udhëzimin e Pagave. Për mjekun e përgjithshëm të familjes (MPF) dhe Drejtorin e QSH-së, në fshat, ky numër është 2600.

Znj. E. T, duke qenë Drejtore dhe mjekë e QSH, ka organizuar banorët e qendrës në mënyrë të tillë që, të ofrojë shërbim për një numër sa më të lartë banorësh, duke ofruar kështu mundësinë për veten e saj, për një pagesë ngarkese të lartë. Ky veprim ka rënë ndesh me standardet e miratuara nga vetë MSHMS dhe Kontratën Dypalëshe.

Lidhur me informacionin e dhënë nga ankuesja se asaj për muajin tetor 2021, i është bërë pagesa e ngarkesës së lartë të banorëve, kjo pagesë është bërë me miratimin e DRF-së, duke qenë në prag të mbylljes së vitit.

Ndërsa refuzimi për një pagesë të tillë në muajin janar 2022, ka ardhur si pasojë e argumentimit se numri i banorëve që mbulojnë me shërbim mjekët e kësaj QSH, është me disnivele mes tyre. Kjo QSH është zonë fushore dhe si e tillë, krijon mundësinë për rishpërndarje të drejtë të banorëve mes mjekëve. Për Drejtorin e QSH-së, ky është një numër i lartë banorësh, duke qenë se krahas aktivitetit si MPF, duhet të ketë dhe kohën e nevojshme për të ushtruar detyrat që rrjedhin nga funksioni i Drejtorit”.

Referuar shkresës sipërcituar, evidentohet se me shkresën me nr. 223 prot., datë 17.02.2022, DRFSDKSH Shkodër i është drejtuar DROSHKSH dhe Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, duke i vënë në dukje problematikën e krijuar në QSH Rrethina, si dhe duke kërkuar të shihet me përparësi mundësia e plotësimit të vendeve vakante me mjekë në këtë QSH.

Me shkresën me nr. 53/3 prot., datë 02.02.2022, DRFSDKSH Shkodër i ka kërkuar Drejtores së QSH Rrethina, të bëjë rishpërndarjen e banorëve në përputhje me normat e vendosura nga MSHMS, si dhe të realizojë ofrimin e mbulimit me shërbim shëndetësor të vendeve vakante, me mjekë të tjerë të kësaj QSH, duke qenë se mjekët e tjerë nuk mbulojnë vende vakante, dhe ndodhur në këtë situatë, ato konsiderohen alternativë tjetër e mundshme.

Me shkresën me nr. 193/1 prot., datë 18.02.2022, DRFSDKSH Shkodër ka miratuar për ankuesen pagesën për mbingarkesë për periudhën 02.02.2022 e deri në lidhjen e kontratës së punës me mjekun e sapoemëruar. I është kërkuar Drejtores së QSH Rrethina gjithashtu, të bëjë riorganizimin e banorëve, duke qenë se situata në QSH ka ndryshuar me emërimin e mjekes së re.

DRFSDKSH Shkodër, në përgjigjen e vet ka parashtruar se kanë vijuar komunikimin shkresor me QSH Rrethina por në kushtet e mungesës së bashkëpunimit dhe të veprimeve që bien ndesh me Kontratën Dypalëshe nga ana e Drejtores, DRFSDKSH Shkodër ka realizuar një kontroll tematik në këtë qendër shëndetësore. Me objekt të përcaktuar: “Identifikimin dhe adresimin e problematikave

mbi “Normat e Ngarkesës”, “Sistemet e informacionit dhe statistikat”, si dhe “Detyrimet mbi zbatimin e legjislacionit financiar”.

Në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, lidhur me sa më sipër, janë gjetur shkelje në çështjet e konstatuara e trajtuara.

Në përgjigjen e DRFSDKSH Shkodër, sqarohet se:

“Në muajin Janar 2022, mjekja Edona Tafa, ka mbuluar me shërbim shëndetësor banorët e ambulancave “Shtoj i Ri”, “Dobraç i Ri”, si dhe vendin vakant “Hot i Ri”, prej një numri total banorësh 9413 banorë.

Ndërsa mjekët e tjerë kanë numrin e banorëve si më poshtë:

H. P, 4210 banorë;

E. Xh, 3246 banorë;

S. S, 4908 banorë;

D. B, 3996 banorë;

V. M, 3006 banorë.

Në muajin shkurt 2022, DRF ka miratuar pagesën për mbingarkesë për mjekët:

- E. T për ambulancat “Shtoj i ri” dhe “Shtoj i Vjetër” në total me 9424 banorë; duke i lënë si detyrë Drejtores që në muajin pasardhës të bëjë riorganizim, pasi ky është një numër i lartë banorësh për një Drejtor QSH, pasi tejkalon standardet e miratuara nga MSHMS, me qëllim që krahas aktivitetit si MPF, të ketë kohën e nevojshme për të ushtruar detyrat që rrjedhin nga funksioni i Drejtorit. Nga verifikimi i deklaratës së aktivitetit mujor për muajin Shkurt 2022, janë raportuar 10913 banorë, nga ku rezultojnë 1489 banorë më shumë se kërkesa e QSH-së dhe miratimi i DRF-së.*
- Mjeku S. S, ka mbuluar me shërbim shëndetësor edhe banorët e ambulancës “Grudë e Re” dhe vendin vakant në ambulancën “Dobraç”, në total me 9873 banorë. Nga verifikimi i deklaratës së aktivitetit mujor për muajin Shkurt 2022, janë raportuar 9000 banorë, nga ku rezultojnë 873 banorë më pak se kërkesa e QSH-së dhe miratimi i DRF-së;*
- Mjekja V. M, ka mbuluar me shërbim shëndetësor edhe banorët e ambulancës “Golem” dhe vendin vakant në ambulancën “Hot i Ri”, në total me 5041 banorë. Nga verifikimi i deklaratës së aktivitetit mujor për muajin Shkurt 2022, janë raportuar 4676 banorë, nga ku rezultojnë 365 banorë më pak se kërkesa e QSH-së dhe miratimi i DRF-së;*

Sa më sipër, është vëne re se ka ndryshim të numrit të banorëve, brenda një harku të shkurtër kohor, ku numri i banorëve për mjekun Edona Tafa është në rritje të vazhdueshme.

QSH Rrethina me shkresën me nr. 86 prot., datë 08.03.2022, ka kërkuar miratim të pagesës për mbingarkesë banorësh, për mjekët E. T dhe V. M, kërkesë e cila nuk është miratuar nga DRF.

Kërkesa e paraqitur nga QSH për muajin Prill 2022, e cila është refuzuar sërish nga DRF, edhe pse QSH ka pretenduar se ka bërë riorganizim, konstatohet se mes mjekëve ka disnivele të banorëve dhe lëvizje të pajustificuar me dokumentacionin “Regjistrim i personit”, për banorët e rinj, si dhe të kërkesës për zgjedhje/ndryshim mjeku të familjes. Nga kontakti i marrë nga

specialistët e kontrollit, me mjekët e kësaj QSH-je, është konstatuar se të sëmurët kronikë janë transferuar tek mjekët që mbulojnë vendet vakante dhe banorët pa sëmundshmëri mbulohen me shërbim shëndetësor nga mjekja E. T, duke copëzuar kështu banorët e një ambulance.

Znj. E. T ka urdhëruar ekonomisten të bëjë pagesën për mbingarkesë të banorëve, pavarësisht mosmiratimit nga DRF, veprim i cili bie ndesh me Kontratën Dypalëshe.

Moszbatimi i detyrimeve kontraktuale ka shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e QSH në vlerën 49721.4 lekë. Për moszbatimet e lartpërmendura, DRF, ka propozuar marrjen e masave, në funksion të përmirësimit të punës, në zbatim edhe të Kontratës Dypalëshe, duke lënë për zbatim 5 (pesë) masa organizative, një masë zhdëmtimi të dëmit ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit të QSH-së, për znj. E. T, në vlerën 49721.4 lekë dhe dy masa administrative gjorbë, në vlerën 2000 lekë për E. T dhe mjekun S. S.

Njëherësh me shkresën me nr. 598 prot., datë 27.05.2022, DRF i ka propozuar DROSHKSH shkarkimin e znj. E. T..

E. T ka ankimuar vendimin e DRF në Komitetin e Shqyrtimit të Administrativ, siç parashikohet në Kontratën Dypalëshe, i cili ka rrëzuar pretendimet e ankueses.

QSH Rrethina me shkresën me nr. 319/1 prot., datë 01.11.2022, ka njoftuar DRF Shkodër për zhdëmtimin e masave të lëna, lidhur me dëmet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të DRF-së.

Me shkresën me nr. 247 prot., datë 24.08.2022, QSH Rrethina, drejtuar nga S. S, i është drejtuar DRF për miratim pagese për mbingarkesë banorësh mbi numrin e lejuar, për mjekët si më poshtë:

S. S, për një numër total prej 4895 banorësh;

G. D, për një numër total prej 4835 banorësh;

Edona Tafa, për një numër total prej 5862 banorësh;

H. P, për një numër total prej 4268 banorësh;

M. H, për një numër total prej 3421 banorësh, kërkesë e cila është miratuar nga DRF.

Pra, bazuar në sa më lart, është bërë e mundur nga Drejtori aktual i QSH Rrethina, mjeku S. S, riorganizimi dhe vendosja e një standardi të përafërt të numrit, mes mjekëve të QSH Rrethina.

Numri i banorëve në QSH Rrethina në muajin Prill 2021, ka qenë 27917 banorë, ndërsa në muajin Mars 2022, ka qenë 28877 banorë”.

DRFSDKSH Shkodër, në prapësimet e dërguara Komisionerit, ka shpjeguar se, lidhur me konfliktin e pretenduar nga ankuesja mes Drejtorit të DRFSDKSH Shkodër dhe asaj, për firmosjen e procesverbaleve të marrjes në dorëzim të inventarizimit të pajisjeve, QSH është institucion i ofrimit të shërbimit shëndetësor në varësi të Operatorit, dhe, DRF ka marrëdhënie kontraktuale me QSH, kontratë e cila ka objekt, financimin e QSH. Inventarizimi i pasurisë së QSH-së, është një detyrim ligjor për t'u kryer në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit. Për kryerjen e këtij procesi, QSH ngre një komision me punonjësit e vetë QSH-së dhe DRF nuk merr pjesë në këtë proces, si dhe nuk disponon dokumentacion lidhur me këtë pretendim. Procedura e ndjekur për këtë qëllim, është pjesë e dokumentacionit të QSH-së.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 9/3 prot., datë 05.04.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri ka kërkuar paraprakisht, që palët në proces të sjellin informacion, prova, si dhe fakte të reja, që mund të mbështesin pretendimet e tyre, lidhur me sa më sipër.

3. Seanca u zhvillua në datë 25.04.2022, me praninë e subjektit ankues dhe B. H, përfaqësuese me autorizim⁹ e DRFSDKSH Shkodër, e cila mban detyrën e juristes pranë këtij Institucioni.

Gjatë seancës dëgjimore, si subjekti ankues, ashtu edhe përfaqësuesja ligjore e DRFSDKSH Shkodër, iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

DRFSDKSH Shkodër iu la si detyrë që të depozitonte pranë KMD-së, në vijim, dokumentacionin provues lidhur me llogaritjen e raportimin e indikatorëve të Qendrave Shëndetësore për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021 dhe gjashtë mujorit të parë të viti 2022, si dhe praktika të ngjashme lidhur me mos miratimin e pagesës së mjekëve për mbingarkesë të numrit të banorëve.

Po ashtu, të dyja palëve iu bë e ditur se mund të depozitonin në vijim të seancës, parashtrime, prova e fakte të tjera shtesë të cilat mbështesnin pretendimet e tyre.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 367/2 prot., datë 08.05.2023, DRFSDKSH Shkodër, depozitoi dokumentacionin e kërkuar, i cili do të referohet në vijim të analizës e arsyetimit të Komisionerit në pjesën e tretë (III-të) të këtij vendimi.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

⁹ Autorizim me nr. 471 prot., datë 20.04.2023 e DRF Shkodër.

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e DRFSDKSH Shkodër.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në këtë kontekst, në ankesën në fjalë, është analizuar dhe vlerësuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme krahasuar me mjekët/drejtorët e tjerë që kanë patur mbingarkesë për numër banorësh.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Pas marrjes së miratimit paraprak nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH me shkresën nr. 2247/1, datë 18.08.2021, OSHKSH Shkodër me Urdhrin nr. 200 datë 27.08.2021 *“Për emërim në detyrë”*, ka kryer emërimin e përkohshëm të znj. E. T, në pozicionin Drejtor/Mjek në Qendrën Shëndetësore “Rrethina”, deri në kryerjen e procedurave standarde.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e sjellë nga palët, nuk rezulton të jetë nënshkruar një kontratë pune mes OSHKSH Shkodër dhe ankuses, por referuar dokumenteve të dorëzuara nga palët, rezulton se marrëdhëniet e punës së ankuses në pozicionin e Drejtores, kanë filluar në datë 27.08.2021.

Në Kreun III, pika 10, të VKM nr. 419, datë 04.07.2018 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”*, parashikohet se: *“Marrëdhëniet e punës të drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të Operatorit në nivel qendror e rajonal, si dhe në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve shëndetësore, qendrat shëndetësore/klinikat dhe institucionet shëndetësore me shtretër/spitalet rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”*

Në nenin 9.1 të Statutit të Qendrës Shëndetësore, të miratuar me Urdhrin nr. 389, datë 07.05.2019, të MSHMS-së, përcaktohet se:

“Neni 1, pika 2.Qendra Shëndetësore, është në varësi të Drejtorisë Rajonale të OSHKSH të rajonit ku shtrin veprimtarinë e saj”. Në nenin 9, pika 1, parashikohet se: “Drejtori i Qendrës Shëndetësore emërohet dhe lirohet nga detyra nga Drejtoria Rajonale e OSHKSH, pasi merr miratim nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH....”, ndërsa në nenin 13 parashikohet se: “2. Procedura disiplinore për drejtorin e QSH kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Operatorit sipas juridiksionit përkatës dhe për punonjësit e tjerë nga Drejtori i QSH, duke respektuar rregullat e përgjithshme, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. 3. Ankimimi i masës së vendosur, bëhet pranë Drejtorisë Rajonale dhe Drejtorisë Qendrore të OSHKSH, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative”.

Neni 21¹⁰, i Kodit të Punës, në pikën 2, të tij, ka përcaktuar se: *“Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëmarrësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës”.*

Për rrjedhojë, në këto kushte, kemi të bëjmë me një kontratë me afat të pacaktuar, pasi punëdhënësi e punëmarrësi kanë vijuar marrëdhëniet e punës në pozicionin Drejtor i QSH Rrethina, nga data 27.08.2021 deri me datë 14.07.2022.

OSHKSH Shkodër me Urdhrin nr. 236, datë 14.07.2022, ka urdhëruar lirim të znj. E. T nga pozicioni “Drejtor” i QSH Rrethina, Shkodër dhe vazhdimin e detyrës si mjek i përgjithshëm familjeje (MPF) pranë kësaj qendre shëndetësore. Lirim nga detyra e Drejtorit ankuesja e ka bërë objekt të një ankese tjetër pranë KMD-së¹¹, për të cilën Komisioneri ka dalë me vendim marrje të posaçme për të.

Komisioneri ka vlerësuar dhe analizuar objektin e kësaj ankese, lidhur me pretendimin e ankueses për mosmiratimin e mbingarkesës së punës nga ana e DRFSDKSH Shkodër, së pari, duke analizuar nëse veprimet e DRF janë të drejta, në përputhje me parashikimet ligjore, përsa i takon mosmiratimit të pagesës për mbingarkesë të banorëve,

dhe së dyti, nëse konstatohet një gjë e tillë, atëherë Komisioneri vlerëson, nëse ky trajtim lidhet apo jo, me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues (konfliktin e krijuar mes saj dhe Drejtorit të DRFSDKSH Shkodër).

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

¹⁰ “Forma e kontratës së punës”.

¹¹ Ankesa me nr. 1 regj., datë 04.01.2023 kundër DROSHKSH Shkodër.

Me shkresën me nr. 729/4, datë 27.08.2021, të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, Shkodër, ankuesja është emëruar¹² në pozicionin “Drejtor/Mjek” pranë Qendrës Shëndetësore Rrethina, Shkodër, deri në kryerjen e procedurave standarde.

Përveç detyrave të natyrës administrative, ankuesja ka mbuluar me shërbim mjekësor dy ambulanca “Shtoj i Ri”, e cila përfshin edhe ambulancën “Dobraç i Ri”, pasi nuk ka në strukturë vend vakant për mjek, dhe ambulancën “Hot i Ri”, gjë e cila rezultonte me mbingarkesë të numrit të banorëve, tej normës së caktuar referuar standardeve të miratuara nga MSHMS dhe të përcaktuara në Kontratën Dypalëshe.

Në këto kushte, ankuesja ka paraqitur kërkesë për miratim mbingarkesë pune, pranë DRFSDKSH Shkodër, kërkesë e cila është miratuar me shkresën me nr. 11142/1 prot., datë 26.10.2021.

Me shkresën me nr. 15 prot., datë 10.01.2022 ka dërguar kërkesën me të njëjtin objekt për rimiratim të mbingarkesës së ambulancës Hot i Ri prej 2500 banorësh.

Me shkresën me nr. 53/1 prto., datë 13.01.2022 DRFSDKSH Shkodër nuk ka miratuar pagesën për mbingarkesë të numrit të banorëve, me argumentimin se: *“Drejtorja Edona Tafa mbulon ambulancat Shtoj i Ri dhe Dobraç me 7361 banorë, numër shumë i lartë ky për një drejtor i QSH-së dhe drejtori mbulon numër më të madh se norma e caktuar, vetëm atëherë kur nuk ka alternativë tjetër.*

VKM nr. 124, datë 05.03.2014 *“Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 1, të tij ka përcaktuar se:

“Fondi është i vetmi organ autonom publik, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Fondi menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

5. Fondi, nëpërmjet organeve të tij drejtuese, ka të drejtë të hartojë dhe të nxjerrë vendime, udhëzime, urdhëresa, rregullore dhe akte të tjera administrative, në mbështetje dhe zbatim të akteve ligjore e nënligjore dhe të kompetencave që i janë dhënë”.

Drejtoritë rajonale janë organe në varësi të Fondit. Ato përfaqësohen nga drejtori i drejtorisë rajonale. Ato zbatojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë e Fondit në hapësirën e tyre administrative në nivel qarku.

Drejtoritë rajonale sigurojnë mbledhjen e kontributeve të sigurimit shëndetësor, identifikojnë dhe pajisin me dokumentin që vërteton sigurimin shëndetësor të personave të siguruar, lidhin kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor të qarkut, mbikëqyrin zbatimin e kontratave të lidhura dhe bëjnë pagesën e tyre sipas mënyrave të parashikuara në to. Ato mbledhin, përpunojnë dhe analizojnë informacionin që lidhet me zbatimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm, zbatojnë rregullat për sigurimin vullnetar, si dhe zbatojnë të gjitha detyrat e deleguara nga drejtori i Përgjithshëm në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë Rajonale të Fondit.

¹² Emërim i përkohshëm.

VKM nr. 737, datë 05.11.2014 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, ka përcaktuar se:

“- Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor publik përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe ofrohen nëpërmjet qendrave shëndetësore.

- Qendra shëndetësore është institucion i shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, publik, jofitimprurës, me llogari bankare të veçantë, që përfshin të gjithë rrjetin e dhënësve të shërbimit në varësi të saj.

- Norma e mbulimit të popullsisë nga personeli shëndetësor i qendrave shëndetësore përcaktohet nga Ministria e Shëndetësisë.

- Qendra shëndetësore përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga drejtori i qendrës shëndetësore, i cili përzgjidhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ministri i Shëndetësisë.

- Qendra shëndetësore e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me standardet e shërbimit, treguesit e cilësisë dhe të performancës dhe në përputhje me përcaktimet e udhërrëfytesve dhe protokolleve të praktikës klinike kombëtare (PKK).

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me qendrën shëndetësore për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre. Fondi nuk financon shërbime të tjera, përveç atyre që ka paketa.

- Forma e kontratës dhe kriteret për lidhjen e saj përcaktohen me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit. - Në kontratën dypalëshe përcaktohen: a) lista e shërbimeve që duhet të ofrojë qendra shëndetësore; b) mënyrat e mbajtjes të të dhënave e të raportimit; c) mënyra e përdorimit të buxhetit nga qendra shëndetësore dhe mënyrat e pagesës së qendrës shëndetësore; ç) treguesit e cilësisë dhe të performancës; d) procedurat për monitorimin e zbatimit të kontratës; dh) mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; e) çështje të tjera që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

- Kontrata mbështetet në parimin e së drejtës së popullatës për t’u informuar dhe për të zgjedhur lirisht ofruesin e shërbimeve shëndetësore, jo më shpesh se një herë në vit, përmes regjistrimit në qendrën shëndetësore.

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron kontroll në qendrën shëndetësore, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

- Mënyrat e pagesës së paketave të shërbimeve shëndetësore, që ofrohen nga qendrat shëndetësore, si dhe pagat e shpërblime të tjera të personelit të qendrave shëndetësore miratohen me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit.

- Qendra shëndetësore zbaton sistemin e referimit, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë”.

Bazuar në sa më sipër, Fondi lidh kontrata më dhënësit e shërbimit shëndetësor dhe i paguan ata për dhënien e shërbimeve shëndetësore, të përfshira në paketat e shërbimeve, si dhe shërbime të përcaktuara me ligje të veçanta.

Objekti i kësaj kontrate është financimi nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor i QSH për dhënien e shërbimeve shëndetësore të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit parësor, si dhe kontrolli mjekësor bazë për shtetasit e grupmohës 35-70 vjeç, që ofrojnë QSH për banorët që

mbulojnë. Për hartimin dhe zbatimin e kontratës, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore në fuqi.

QSH, është institucion shëndetësor në varësi të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, që jep shërbimi shëndetësor në kujdesin parësor bazuar në legjislacionin specifik.

Sa më sipër, DRF nuk lidh kontratë pune individuale me personelin e QSH, por lidh kontratë dypalëshe financimi, në të cilën përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, duke rregulluar marrëdhënien ndërinstitucionale.

Në këtë kontekst, dhe në zbatim të sa më sipër, ndërmjet DRF dhe QSH “Rrethina”, me datë 10.01.2022, është nënshkruar Kontrata “Për financimin e QSH për vitin 2022”, e cila ka përcaktuar respektivisht:

- Në nenin 5, të saj “Normat e ngarkesës dhe sistemi i referimit”, përcaktohet se:

“1. QSH, është përgjegjëse për regjistrimin e banorëve, nëpërmjet personelit mjekësor të kontraktuar. Banorët zgjedhin Mjekun e Përgjithshëm dhe të Familjes (në vijim MPF) në bazë të parimit të zgjedhjes së lirë. Pjesëtarët e një familjeje rekomandohet të regjistrohen tek i njëjti mjek. Banorët kanë të drejtë të ndryshojnë MPF, jo më shpesh se një herë në vit, pasi të kenë kryer çrregjistrimin tek mjeku i mëparshëm.

2. Numri i banorëve të rregjistruar tek një MPF, duhet të jetë në përputhje me standardet që ka përcaktuar MSHMS. MPF, janë të detyruar të bëjnë mbulimin shëndetësor të banorëve, mbi normën e standardeve të miratuara, vetëm atëherë kur nuk ka alternativë tjetër.

3. QSH, për rastet kur numri i banorëve të rregjistruar tek një MPF, është mbi standardet e miratuara nga MSHMS, duhet të kërkojë miratim dhe rimiratim në DRF për aq kohë sa mjekët punojnë në kushtet e mbingarkesës. Në rastet e ngarkesës nën standartet e miratuara nga MSHMS (vetëm për rastet me nënngarkesë për shkak të vështirësive të terrenit) QSH duhet të kërkojë miratim për herë të parë në Fond. Propozimet e QSH për miratim nën ngarkesë të dërgohen në Fond nëpërmjet DRF, duke argumentuar rastin.

4. Në rastet e mjekëve të përgjithshëm për moshat pediatrike ose për të rritur, që nuk plotësojnë normën e banorëve sipas standardeve të miratuara, drejtori i QSH i propozon Fondit, ndryshimin e klasifikimit të mjekut nga mjek i familjes për moshat pediatrike në mjek të familjes për të gjithë grup-moshat ose për të rritur, dhe nga mjek Kontratë për financimin e qendrave shëndetësore për vitin 2022 8 /67 i familjes për të rritur në mjek të familjes për të gjithë grup-moshat. Propozimet e QSH (kundrejt kërkesës së paraqitur nga vetë mjeku) për ndryshim klasifikimi MPF të dërgohen në Fond nëpërmjet DRF, duke argumentuar rastin.

Neni 7, “Sistemet e informacionit dhe statistikat”, të kësaj Kontrate, ndër të tjera, përcaktohet se;

“QSH, është përgjegjëse për zbatimin e sistemeve informatike për shërbimin shëndetësor parësor, për regjistrimin e formularëve të vizitës dhe procedurave Kontratë për financimin e qendrave shëndetësore për vitin 2022 9 /67 mjekësore, plotësimin dhe raportimin e të gjitha formateve të printuara dhe elektronike që lidhen me të ; a. Formulari “Regjistrim i personit” për banorët e

rinj” (Aneksi M); b. Formulari “Kërkesë për zgjedhje/ndryshim mjeku të familjes” - Aneksi O; c. Formulari “Çregjistrim i personit të vdekur” Aneksi N; d. “Formulari i kontrollit mjekësor bazë” Aneksi P; e. “Përgjigjja përfundimtare për kontrollin mjekësor bazë” Aneksi P/1.

QSH, detyrohet t’i paraqesë DRF në mënyrë të saktë dhe në afatin e duhur të dhënata statistikore dhe të dhënata elektronike, sipas anekseve bashkëngjitur kësaj kontrate. QSH, në zbatim të kësaj kontrate, ju përgjigjet kërkesave të veçanta për informacion të DRF dhe Operatorit rajonal dhe vendos në dispozicion të tyre dokumentacionin mbi të cilin janë raportuar të dhënata...”.

Kontrata përcakton edhe detyrimet e drejtorit të QSH, të cilat specifikohen si më poshtë:

- “Organizon dhe drejton punën në QSH, për dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor të kontratuar, nga ana sasiore dhe cilësore. Përgjigjet për funksionimin dhe mbarëvajtjen e shërbimit të urgjencës, pranë QSH.
- Organizon punën për funksionimin e sistemit të referimit, në të gjithë hallkat e tij.
- Lidh kontratën për financimin e QSH me DRF. Në zbatim të Kodit të Punës drejtori i qendrës shëndetësore lidh kontratën e punës individuale me secilin punonjës të QSH, duke i arshivuar në dosjen personale të secilit. Kontrollon zbatimin e orarit të miratuar të shërbimit të QSH dhe disiplinës në punë, në bashkëveprim me përfaqësuesin e njësisë administrative vendore. Kryen shpërblim të diferencuar të personelit shëndetësor sipas kontributit individual, të matshëm në realizimin e indikatorëve të performancës dhe cilësisë.
- Drejtori është nëpunës autorizues i QSH dhe cakton një ekonomist, si nëpunës zbatues, zbaton buxhetin e alokuar për qendrën shëndetësore sipas rregullave që përshkruhen në këtë kontratë. Raporton të dhënata statistikore dhe financiare të kërkuara nga DRFSDKSH / Fond (për buxhetin e financuar nga Fondi) të printuara edhe elektronikisht dhe në Operatorin Rajonal (për buxhetin e financuar nga Operatori/MSHMS), brenda afateve kohore dhe kontrollon saktësinë e plotësimit.
- Organizon punën për mirëmbajtjen e “Rregjistrimit elektronik të banorëve me banim të përhershëm”, përditësimin dhe transferimin e listës së pacientëve nga njëri mjek tek tjetri. Përgjigjet për organizimin, mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit shëndetësor, në kujdesin parësor.
- Pranon kontrollin e Fondit/DRF/DF/Operatorit, zbaton masat e rekomanduara prej tyre, për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë brenda afateve të përcaktuara dhe mban përgjegjësi për mos zbatimin e tyre. Informon me shkrim brenda afateve kohore, strukturën kontrolluese mbi zbatimin e masave të rekomanduara.
- Zhvillon çdo muaj analizën e aktivitetit të QSH me personelin shëndetësor, raporton me shkrim të DRF dhe Operatorit dhe merr pjesë në mbledhjet mujore pranë DRF si dhe në mbledhjet mujore të Operatorit.
- Përgjigjet për inventarin aktual të mjeteve, materialeve, pajisjeve në përdorim të QSH dhe siguron ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Përgjigjet në lidhje me tejkalimet e pa argumentuara të rimbursimit të mjekëve duke i dokumentuar të gjitha luhatjet e rimbursimit të mjekëve me kontrole mujore të brendshme.

- Të kryejë shpërblim të diferencuar të personelit shëndetësor sipas kontributit individual të matshëm në realizimin e indikatorëve.
- Të njoftojë menjëherë DRFSDKSH/Fondin për pajisjen me akses në në sistemet elektronike në përdorim dhe pajisjen me USB që mbart nënshkrimin elektronik të mjekëve të sapoemëruar.
- Të njoftojë menjëherë DRFSDKSH/Fondin për mbylljen e aksesit në sistemet elektronike në përdorim dhe revokimin e pajisjes (USB) që mbart nënshkrimin elektronik për mjekët që largohen.
- Merr pjesë në takimet periodike të organizuara nga DRFSDKSH mbi realizimin e treguesve të indikatorëve të performancës dhe cilësisë të QSH.
- Argumenton nivelin e treguesve të performancës dhe cilësisë dhe propozon planin e masave për respektimin e targetit të treguesve sipas Aneksit H, dhe zgjidhjen e problematikave shoqëruese të aktivitetit të QSH. Monitoron plotësimin e saktë të formularëve të vizitës dhe procedurave mjekësore sipas manualeve përkatëse dhe akteve administrative të Fondit.

Nga ana tjetër, neni 18, i Kontratës “Detyrimet e DRFSDKSH”, ka përcaktuar respektivisht, si më poshtë citohet:

- Të përmbushë plotësisht dhe në kohë kërkesat e përcaktuara në nenin 19 (Financimi i QSH) të kësaj kontrate.
- Të informojë QSH për ndryshimet në dispozitat ligjore, standardet, normat dhe udhëzimet, për të mundësuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të QSH.
- Të pajisë QSH me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen dhe evidentimin e aktivitetit profesional, si dhe me Listën e Barnave të Rimbursueshme, protokollet e përdorimit të barnave, aktet ligjore e nënligjore në zbatim të skemës së sigurimit shëndetësor.
- Të bëjë supervizimin periodik të QSH, sipas udhëzuesve metodik të miratuar, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në çdo kohë nga ana e QSH.
- Pas çdo kontrolli, përpilohet një raport standard që përmban pasqyrimin e situatës së konstatuar. Organi që ushtron kontrollin për shkeljet kontraktuale të identifikuara, ka për detyrë t’i kërkojë QSH marrjen e masave të karakterit organizativ, administrativ, disiplinor, detyrim për shpërblim dëmi dhe zgjidhje të kontratës individuale të punës, në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate.
- DRFSDKSH ka të drejtën dhe detyrimin, që kur konstaton keqmanaxhim të fondeve të QSH nga ana e drejtorit, të përgatisë dosjen me propozimet përkatëse për autoritetin përkatës.
- Të monitorojë zbatimin e programit të regjistrimit të formularit të vizitës dhe procedurave mjekësore në kujdesin parësor, të pajisë me udhëzueset përkatëse dhe dokumentacionin e nevojshëm që i duhet QSH për zbatimin e këtij programi. T’i vendosë në dispozicion QSH të gjitha raportet dhe analizat e prodhuara, që kanë lidhje me aktivitetet e QSH.
- Të informojë periodikisht QSH në lidhje me treguesit e aktiviteteve të saj (rimbursimit, indikatorëve, sëmundshmërisë).

- T'u përgjigjet propozimeve dhe kërkesave të QSH apo të banorëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.
- Të shqyrtojë ndryshimet e klasifikimit të MPF, sipas kërkesës së QSH dhe të dërgojë për miratim në Fond kërkesën e argumentuar.
- Verifikon rezultatet e kontrollit mjekësor bazë për çdo QSH dhe në afatet e caktuara me udhëzim i dërgon në Fond. Monitoron hedhjen në sistemin "Si Je?" të përgjigjes Kontratë për financimin e qendrave shendetësore për vitin 2022 /67 përfundimtare nga QSH sipas afateve të përcaktuara si dhe hedhjen në sistemin evizita të vaksinës Covid -19.
- Merr masa për monitorimin e procesit të mbulimit me shërbime të kujdesit parësor për banorët e QSH, në rastet kur nuk ka mjekë të përgjithshëm dhe të familjes.
- Ofron asistencë teknike në rastet kur kërkohet nga QSH për saktësimin, përditësimin dhe pastrimin e regjistrit elektronik të banorëve të përhershëm.
- Monitoron aktivitetin e kontrollit mjekësor bazë për çdo QSH, verifikon rezultatet mujore të kontrollit për çdo kabinet dhe dërgon në Fond pasqyrën përmbledhëse të QSH sipas udhëzimeve të Fondit.
- Mbështet QSH në realizimin e procesit të planifikimit institucional të profesionistëve të saj për pjesëmarrje në aktivitetet e edukimit profesional në vazhdim.

Neni 21, i Kontratës, ka parashikuar sanksionet për moszbatim të detyrimeve kontraktuale, duke përcaktuar se: *"Pas çdo kontrolli të ushtruar nga DRF/Fond, në bazë të shkeljeve të konstatuara, organi që ushtron kontrollin ka detyrim t'i rekomandojë organeve drejtuese të QSH masat e karakterit organizativ, administrativ, kushte penale, disiplinor, detyrim shpërblim dëmi, zgjidhje kontrate individuale dhe kallëzim penal. Drejtori i QSH mban përgjegjësi për zbatimin e këtyre masave"*.

Neni 22, i Kontratës, ka parashikuar se:

" Subjekti ose personi përgjegjës ndaj të cilit është vendosur një sanksion sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni e vendimit me sanksionin përkatës.

2. Ankimi administrativ duhet të përmbajë këto elemente: a. subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij; b. procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi; c. një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse; d. pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar; e. provat dhe dokumentacionin përkatës të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komiteti.

3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton brenda 30 ditëve ankimin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni, por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative. 4. Ankimi administrative, i paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.

5. Kundër vendimit të Komitetit, subjekti mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë”.

Bazuar në legjislacionin sa më sipër, si dhe kronologjinë e veprimeve të palëve në këtë proces, (ankueses në tagrin e Drejtores së QSH dhe Drejtorit të DRF Shkodër), Komisioneri konstaton se, nga ana e DRF-së, nuk janë ndërmarrë veprime të padrejta e të pafavorshme kundrejt ankueses, përse i takon mosaprovimit nga ana e tij për pagesën e mbingarkesës për muajin Janar 2022, duke arsyetuar se:

Sa i takon pretendimit të ankueses për numrin e banorëve që ka mbuluar Drejtori i mëparshëm i QSH Rrethina, Komisioneri sqaron se, në vitin 2019, miratimi i mbingarkesave bëhej nga Fondi dhe ishte përgjegjësi e kompetencë e tij, ndërsa në Kontratën e vitit 2020, pika 3, e nenit 5, të saj, ka ndryshuar këtë kompetencë duke ia ngarkuar miratimin e mbingarkesës së banorëve, DRF.

Së pari, Drejtori i DRF Shkodër nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e miratimit të mbingarkesës së banorëve (për veten e tij) kur mbante detyrën e Drejtorit të QSH Rrethina, pasi këtë kompetencë e kishte DF, e cila ka bërë miratimin përkatës, ndërsa aktualisht e ka DRF.

Së dyti, Drejtori i DRF Shkodër, në momentin kur mbante detyrën e Drejtorit të QSH Rrethina, ka paraqitur kërkesën për miratim mbingarkese, kërkesë e cila është miratuar nga DF.

Së treti, bazuar në faktin se Drejtori i DRF ka mbajtur më parë pozicionin që kishte ankuesja, atë të Drejtorit të QSH Rrethina, ai supozohet të ishte në dijeni të faktit se sa ishte numri i banorëve të qendrave respektive, dhe se, fakti se nga ankuesja ishin raportuar shifra më të larta, kishte ngritur dyshime të arsyeshme, për të cilat ai fillimisht ka refuzuar miratimin e kësaj mbingarkese (e para se numri ishte ndjeshëm më i lartë, për një periudhë kohore relativisht të shkurtër, dhe e dyta, pasi ngarkesa e saj si Drejtore duhet të ishte më e ulët dhe se ngarkesa për numër banorësh duhej riorganizuar, sipas udhëzimeve të DRF), duke kërkuar nga ana e ankueses/Drejtores e QSH, të bëhej riorganizimi i banorëve të qendrave shëndetësore që ajo mbulonte si titullare e QSH Rrethina.

Numri maksimal i banorëve që duhet të mbulojë Drejtori i QSH, është i përcaktuar e miratuar nga MSHMS, numër i cili po ashtu është i konfirmuar edhe në Udhëzimin e Pagave, ku për MPF dhe Drejtorin e QSH në fshat, ky numër është 2600 banorë. Bazuar në këto akte, pagesa e mjekut të QSH-së, ka disa elementë, ndër të cilët është edhe pagesa e ngarkesës për banorë. Kjo pagesë përfitohet nga mjekët e QSH, në bazë të numrit të banorëve që ato mbulojnë, duke e shumëzuar me koeficientin e përcaktuar në Udhëzimin e Pagave, miratuar nga Këshilli Administrativ, i cili është një organ kolegjal vendimmarrës.

Së katërti, bazuar në kompetencat e DRFSDKSH-së, dhe përcaktimet në Kontratën Dypalëshe mes DRFSDKSH dhe QSH Rrethina, QSH, për rastet kur numri i banorëve tek një MPF është mbi standardet e miratuara nga MSHMS, duhet të kërkojë miratimin në DRFSDKSH, për aq kohë sa mjekët punojnë në kushtet e mbingarkesës.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, DRFSDKSH, bazuar në kompetencat që i burojnë nga legjislacioni specifik, nisur nga indiciet e të dhënave të veta për pasaktësi në raportimet e bëra lidhur me numrin e banorëve të raportuar nga ankuesja, ka refuzuar të miratojë kërkesën e bërë prej saj për një mbingarkesë banorësh për të dhe për dy mjekë të tjerë të qendrave shëndetësore në varësi të QSH Rrethina, drejtuese e të cilës ishte. Kështu:

Është konsideruar se numri i banorëve që mbulojnë mjekët e kësaj qendre, është shumë më i lartë se norma (standardi i përcaktuar) dhe me disnivele mes tyre. Në këto kushte, DRF, i është drejtuar ankueses/Drejtores e QSH me shkresë, ku i ka kërkuar të marrë masa për rishpërndarjen e banorëve në përputhje me normat e vendosura nga MSHMS, si dhe të realizojë ofrimin e mbulimit me shërbim shëndetësor të vendeve vakante, me mjekë të tjerë të kësaj QSH, duke qenë se mjekët e tjerë nuk mbulonin vende vakante dhe mund të konsideroheshin si një alternativë e vlefshme.

Ndodhur në kushtet e moszbatimit të rekomandimeve të lëna për rregullimin e situatës së rishpërndarjes të ngarkesës së banorëve, nga ana e QSH Rrethina, DRF, ka urdhëruar një kontroll tematik në këtë qendër, në zbatim të Programit të Kontrollit Tematik me nr. 519, datë 10.05.2022. Bazuar në këtë program, grupi i kontrollit të DRF Shkodër, me datë 10.05.2022, ka ushtruar kontroll në QSH Rrethina, me objekt kontrolli: *“Identifikimi dhe adresimi i problematikave mbi normat e ngarkesës, sistemet e informacionit dhe statistikave, si dhe detyrimet mbi zbatimin e legjislacionit financiar mbështetur në Kontratën Dypalëshe DRF- QSH 2022”*.

Bazuar në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, ku janë trajtuar e konstatuar një sërë shkeljesh, për të cilat ankueses në tagrin e mjekes/Drejtores së QSH, i është ngarkuar masë zhdëmtimi “dëm ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit”, në vlerën e përcaktuar në këtë akt-konstatim, DRFSDKSH ka dalë me Vendimin me nr. 519/2 prot., datë 27.05.2022 “Vendime dhe rekomandime pas kontrollit të ushtruar në QSH Rrethina, mbi kontrollin tematik”.

Ky vendim është kundërshtuar nga subjekti ankues nëpërmjet ankimimit të saj me shkresën me nr. 4316 prot., datë 27.06.2022, pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ (në vijim Komiteti).

Në përfundim të shqyrtimit të ankimimit të ankueses, Komiteti, me Vendimin nr. 9, datë 26.07.2022, ka disponuar me mospranim të ankimimit të palës ankuese Edona Tafa, me arsyetimin se pretendimet e ngritura prej saj, nuk kanë mbështetje e argument ligjor; vendim i cili nuk është ankimuar gjyqësisht.

Gjatë arsytimit të Komitetit, evidentohet, ndër të tjera, se:

- Për muajin Janar 2022 (për të cilin dhe ka ngritur pretendimet pranë KMD-së) pagesat për banorë për mjekët e QSH Rrethina janë bërë konform miratimit të DRFSDKSH, në përputhje me deklaratat mujore të aktivitetit të mjekut.
- Për muajin Shkurt, DRFSDKSH ka miratuar pagesën për ngarkesë për banorë. Për mjeken E. T, nga verifikimi i deklaratës së aktivitetit mujor për këtë muaj, janë raportuar 1.489 banorë më shumë se miratimi i DRFSDKSH. Pagesa e bërë për banorë nga ana e ankueses

është bërë për 10778 banorë, pra më tepër se miratimi, duke përfituar një vlerë më të lartë në lekë.

- Për muajin Mars 2022, DRFSDKSH, nuk ka miratuar kërkesën e QSH, pasi ka konstatuar shkelje.

Komisioneri, vëren se në këtë logjikë, janë evidentuar nga DRFSDKSH të gjitha shkeljet e Drejtores së QSH përse i takon pagesës në vlerë më të lartë se duhet të ishte, duke përfituar në mënyrë të padrejtë një pagesë më të madhe.

Komiteti ka konstatuar se pagesat e kryera nga E. T, janë bërë në kundërshtim me bazën ligjore ku përcaktohet një gjë e tillë.

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ është një organ vendimmarrës kolegjal, i ngritur pranë FSDKSH, në përbërje të të cilit janë 5 (pesë) anëtarë.

Komisioneri gjykon se, bazuar në sa më sipër, pretendimi i ankueses se nga ana e DRFSDKSH nuk i është vënë në dispozicion vendimi i Komitetit dhe se ajo nuk është njohur me të, në mënyrë që të kishte mundësinë për ta kundërshtuar gjyqësisht atë, nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi DRFSDKSH ka qenë palë në këtë proces administrativ para Komitetit/FSDKSH, njëjloj si ankuesja, dhe se detyrimin për njoftimin e komunikimin e vendimit e ka organi vendimarrës dhe jo DRFSDKSH.

Edhe nëse do të merret i mirëqenë fakti se ankueses nuk i është komunikuar vendimi, ky fakt nuk ngarkon me përgjegjësi DRFSDKSH, e cila nuk ka asnjë përgjegjësi për sa më sipër, duke qenë se nuk është pjesë e vendimmarrjes dhe për më tepër, është pjesëmarrëse (në cilësinë e palës së ankimuar) njëjloj si ankuesja në këtë proces administrativ.

Komisioneri vlerëson se, Komiteti është organi vendimmarrës kompetent lidhur me shqyrtimin e vlerësimit e pretendimeve të ankueses lidhur me ligjshmërinë apo jo të veprimeve të DRFSDKSH, përse i takon mosmiratimit të ngarkesës së banorëve për MPF pranë QSH, vendimmarrja e të cilit është në fuqi, pasi nuk është kundërshtuar gjyqësisht.

Nga ana tjetër, Komisioneri vëren se, kjo praktikë e DRFSDKSH, lidhur me mosmiratimin e kërkesave për pagesë të mbingarkesë të banorëve apo transferim të banorëve në ambulanca të mbuluara nga MPF/Drejtorë të Qendrave të tjera, është ndjekur edhe për MPF të tjerë, njëjloj si për ankuesen:

Kështu, bazuar në aktet shkresore të depozituara pranë KMD-së rezulton se, është refuzuar kërkesa e R. K, MPF/Drejtori i QSH Shkrel, me të njëjtin arsyetim si për subjektin ankues.

Nuk është miratuar mbingarkesa e banorëve nga DRFSDKSH, me të njëjtin arsyetim edhe për mjeken V. M.

Komisioneri vëren se, sipas shkresës me nr. 319/1 prot., datë 01.11.2022, DRFSDKSH, i komunikohet nga Drejtori S.S i QSH Rrethina se, bazuar në masën e vendosur për zhdëmtim dëmi

ekonomik të shkaktua nga QSH, është nxjerrë urdhër zhdëmtimi, është kryer kontabilizimi dhe ndalesa e vlerës së plotë të dëmit ekonomik, për llogari të QSH, në shumën 49.721.4 lekë për MPF E. T.

Pas riorganizimit të banorëve, të bërë nga drejtori aktual i QSH, S. S, evidentohet se DRFSDKSH, bazuar në këtë rishpërndarje, edhe pse sërish ka mbingarkesë banorësh për MPF, është bërë miratimi i pagesës së mbingarkesës nga ana e DRF, për mjekët:

S. S, G.D, E. T, H. P dhe M. H , respektivisht sipas numrit të banorëve që mbulonte secili prej tyre, pasi DRF, ka vlerësuar se nga ana e Drejtorit të QSH, është bërë një riorganizim dhe është vendosur një standard më i përafërt të numrit të banorëve, mes mjekëve të QSH Rrethina, sipas standardeve të vendosura nga MSHMS dhe Kontrata Dypalëshe DRFSDKSH – QSH 2022.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e DRFSDKSH Shkodër (DRF), pasi, gjetjet dhe konstatimet e bëra nga DRF janë konform dhe në përmbushje të kompetencave e parashikimeve ligjore për sa ka konstatuar në raport me pretendimet e ankueses, për arsye se:

- Gjetjet dhe konstatimet e bëra nga DRFSDKSH i janë nënshtruar vlerësimit të organit kompetent për shqyrtimin e tyre, që është Komiteti i Shqyrtimit Administrativ, pas ankimimit të ankueses;
- Vendimmarrja e DRFSDKSH lidhur me shkeljet e evidentuara të ankueses është konsideruar e drejtë dhe e bazuar në ligj nga Komiteti, duke u lënë në fuqi nga ky i fundit;
- Vendimmarrja e Komitetit është në fuqi pasi nuk është kundërshtuar gjyqësisht, dhe në këtë kontekst konkluzionet e disponuara prej tij, merren të mirëqena.
- Gjithashtu, DRFSDKSH, ka ndjekur një praktikë të njëjtë si për ankuesen, ashtu dhe për persona të tjerë në kushte të ngjashme me të (cituar më lart në vendim) për sa i takon mosmiratimit të ngarkesës së banorëve.
- Fakti që për muajin shkurt dhe mars 2022 ankueses, së bashku me mjekët e tjerë, ndodhur në kushtet e rishpërndarjes dhe riorganizimit të tyre, pas ardhjes së drejtorit të ri të QSH-së, (pas largimit të ankueses) i janë miratuar pagesat për mbingarkesë banorësh mbi maksimalen e lejuar, është një tregues që, me ndryshimin e këtyre kushteve (të cilat i ishin rekomanduar edhe ankueses para largimit për t'u konsideruar, nga ana e DRFSDKSH) pavarësisht se sërish numri i banorëve ishte mbi normën e lejuar, riorganizimi i kishte bërë të mundur vendosjen e një standardi më të përafërt të numrit të banorëve mes mjekëve të QSH Rrethina, me një diferencë të vogël mes tyre, varësisht edhe nga rrethanat specifike të qendrave respektive:

S. S, për një numër total prej 4895 banorësh;

G. D, për një numër total prej 4835 banorësh;

E. T, për një numër total prej 5862 banorësh;

H. P, për një numër total prej 4268 banorësh;

M. H, për një numër total prej 3421 banorësh.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të saj, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e DRFSDKSH Shkodër.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRFSDKSH Shkodër, ardhur për shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të saj, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e DRFSDKSH Shkodër.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRFSDKSH Shkodër, ardhur për shkak të konflikteve të prezumuara mes titullarit të institucionit dhe subjektit ankues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, E. T, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Çdo shkak tjetër

